TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Vernige

VELATURA

ASTAR PËR SIPËRFAQE DRURI



PËRSHKRIMI TEKNIK

VELATURA është një nënshtresë boje me bazë solventi që përmban sasi të madhe substancash të ngurta dhe është e dizenjuar posaçërisht për aplikime dekorative të brendshme dhe të jashtme si në dru dhe në metal. Nuk ka përmbatje metali. Është e disponueshme në ngjyrë të bardhë.

CILËSITË

Duke qenë shumë elastike është në gjendje t'u rezistojë punimeve të drurit. Ka aftësi mbushëse dhe niveluese të shkëlqyera. Përdoret lehtë në lyerje dhe e ruan bardhësinë duke qenë rezistente ndaj zverdhjes. Është rezistente ndaj ujit, vajrave minerale dhe tretësave organik.
Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë, rul ose pistoletë.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret si astar në aplikimet dekorimeve mbi dru ose metal. Mund të përdoret në dyer druri dhe metalike, dritare, makineri, binarë, anije, mobilje, parmakë, etj. Gjithashtu, mund të aplikohet në lodrat prej druri dhe në objektet zbukuruese prej druri dhe metalike.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/i (Bojra specifike me nje komponent): 500g /l (2010). Ky produkt përmban maksimalisht 499 g/l VOC.



ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

VELATURA

ASTAR PËR SIPËRFAQE DRURI

APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër dhe e thatë, pa praninë e yndyrnave, pluhurave, ndryshkut dhe kripërave.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% me BRUSH SOLVENT No 100, sipas peshës.
Hollimi për pistoletë: 5-10% me SPRAY SOLVENT No 200, sipas peshës.
Aplikimi: Aplikoni 1-2 shtresa **VELATURA** mbi sipërfaqen e pastruar dhe të përgatitur mirë. Ditën tjetër kjo sipërfaqe duhet të fërkohet me letër zmerile 280-320 dhe pastaj të aplikohen 1-2 shtresa me ZEUS-METAL.
Në sipërfaqet prej alumini dhe të xinguara: Në fillim apliko 1-2 duar me WASH PRIMER të **ZEUS-AL**.
Kujdes: Mbi **VELATURA** ju mund të aplikoni vetëm produkte me një komponent.
Temperatura e aplikimit: 5 deri në 35°C.



TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë
Rezina: Rezinë Alkide
Densiteti (e bardhë): 1.30±0.01 gr/ml (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Shkëlqimi, në 60°: 20±5 (ELOT EN ISO 2813-99)
Viskoziteti, DIN 6, në 25° C: 60-80 sec (ISO 2884.02-03)
Viskoziteti në aplikim me pistoletë 4mm: 18-22 sec (ISO 2884.02-03)
Substanca të ngurta sipas peshës: %: 72±2 (ELOT EN ISO 3251-03)
Koha e tharjes në 25° C:

- Tharja në sipërfaqe: 20-35 min
- Tharja në prekje: 2-3 orë
- Tharja ne brëndësi: 16 orë
- Rilyerja: pas 16-24 orë

Pika e ndezjes: 26° C (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në metal/dru (ndër-prerë): 0-1 (ELOT EN ISO 2409-95)
Fortësia (Könnig): 45 ±5 pas 7 ditësh (ELOT EN ISO 1522-00)
Elasticiteti (testi i Mandrel): 4±1 mm pass (ELOT EN ISO 1519-02)
Mbulimi: 9-10 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura më parë.

PËR APLIKIMIN ME PISTOLETË
Përdoreni gjithmonë në ambiente të ajrosura mirë duke përdorur maskë dhe doreza të përshtatshme për mbrojtje. Mos thithni avujt.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com